REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA
AUTORITETI KOMBËTAR I KUALIFIKIMEVE
NACIONALNI AUTORITET ZA KVALIFIKACIJE
NATIONAL QUALIFICATION AUTHORITY
Nr.Prot: 394/13 Data: 15.01.13
Br. Prot: Datum:
Prot. No.: Date:
PRISHTINË/PRIŠTINA/PRISTINA

Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 394/13
Datë 15.01.2013

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 mbi Kualifikimet Kombëtare të datës 7 nëntor 2008 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 1/2011- Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me nenet 4,7,10 dhe 16, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve me datë 15.01.2013 nxjerr këtë:

VENDIM

1. Qendra Rajonale për Aftësim Profesional, Prishtinë, duhet plotësuar kushtet deri në afatin e caktuar, për të marr akreditim dhe aprovim për këtë/o kualifikime:

1.1. Furrtari - (niveli i KKK-së III)

Validimi i kualifikimit dhe akreditimi i institucioni/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim:

Kushtet:

- Të plotësohet kuadri me përgatitje të lartë profesionale për mbulimin e pjesës teorike profesionale në harmoni me standardin profesional-Furrtar.

- Kualifikimin Furrtar të cilin e ofron QRAP me të gjitha specifikat e moduleve, paketën mësimore (materialin mësimor), rezultatet e matshme, programin e kursit për furrtari si dhe kriteret e vlerësimit teorikë-praktik duhet të jenë të harmonizuara dhe në përputhshmëri me standardin e profesionit të furrtarit.

- Depoja për ruajtjen e prodhimeve ushqimore të kompletohet me pajisje të nevojshme sipas standardeve për ruajtjen e prodhimeve ushqimore.

- Pajisjet jo funksionale dhe të dëmtuara në tualete të rregullohen dhe të jenë funksionale.

- Të sigurohet një hapësirë më e përshtatshme për ndërrimin e gardërobës për kursantet.

- Të sigurohet pajisja teknologjike për fletëzimin e brumit, të sigurohen pajisje për dhënien e formave për pjekurina nga brumërat.

- Të bëhet vendosja e shenjave udhëzuese në pajisjet për përdorim.

- Të krijohen mundësi për lidhje bashkëpunimi me bizneset e ndryshme furrtare.

- Të rregullohet ambienti i jashtëm i QRAP, në përputhshmëri me standardet për mbrojtjen e mjedisit.

- Të pajisen me libreza sanitare trajnerët dhe kursantet.

Afati përmbushjes se këtyre kushteve është: 30.06.2013

2. Arsyetim

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit, me datë:15.01.2013, Këshilli Drejtues i AKK-së merr këtë vendim bazuar në rekomandimet të dala nga Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Validimin e kualifikimit, Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Akreditimin e Institucionit i cili ofron dhe/ose vlerëson dhe lëshon kualifikime të aprovuara dhe këto rekomandime janë të mbështetura në fakte dhe dokumente si në vijim:

-Aplikacioni për Validim të Kualifikimit/Modulit;
-Aplikacioni për Akreditim si Institucionit Ofrues dhe/ose Vlerësues dhe Lëshues të Kualifikimit;
-Raporti i Vetë-vlerësimit;
-Vizita në institucionin/ofruesin aplikues, dhe
- Dokumente tjera shtesë.

2.1. Pala e pakënaqur me vendimin, ka drejtë ankese në organet e shkallës së dytë.
Ankesa bëhet përmes organit të shkallës së parë.

3. Kushtet e parashtruara për aprovim dhe akreditim duhet të përmbushen në afatin e caktuar nga AKK, në rastin kur institucioni/ofruesi nuk i përmbushë këto kritere, AKK ka të drejtë tërheqjen e ofruar për aprovim dhe akreditim.

4. Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit të tij.

5. Vendimi u dërgohet:

- QRAP, Prishtinë;
- AKK-së.

Kryetari i KD së AKK-së
Ragip Gjoshi